



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE**  
**KORÇE**

---

**Nr. 86/852 Regj. Them**  
**Data e Regj: 07.11.2014**

**Nr.91 Vendimi**  
**Data:17.02.2015**

**V E N D I M**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

**SOKOL IBI - Gjyqtar**

Asistuar prej sekretares Marinela Rushi, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 17.02.2015, çeshtjen administrative me Nr.86/852 Regj. Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

**PADITES:** “Lavdiqe Lato” person fizik, e perfaqesuar ne gjykim me prokure te posaçme Nr.384 Rep, Nr.114 Kol, date 28.01.2015 nga Av: Genti Simaku me Nr.4911 license, Dhoma e Avokatise Tirane.

**I PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga.

**OBJEKTI:** Anullimi i aktit administrativ “Njoftim vleresimi per detyrimet Tatimore” me Nr.10843, date 02.07.2014, i lene ne fuqi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane me vendimin Nr.211184/1 Prot, date 01.10.2014 si dhe detyrimin e Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe per fshirjen e gjobave konform ligjit Nr.10418, date 21.04.2011.

**BAZA LIGJORE:** Ligjit Nr.9920, date 19.05.2008, ligji Nr.8485, date 12.05.1999, ligji Nr.10418, date 21.04.2011.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, degjoi konkluzionet perfundimtare te pales paditese e cila perfundimisht kerkoi pranimin e padise, te pales se paditur e cila perfundimisht kerkoi rrezimin e padise,

### VEREN

Se paditesi "Lavdije Lato" person fizik ka paraqitur para kesaj gjykate kerkesepadine me objektin e mesiperm.

Gjate gjykimit rezultoi e provuar se pala paditese eshte nje person fizik tregetar qe e ushtron aktivitetin e saj tregetar ne qytetin e Pogradecit.

Nepermjet njoftim vleresimit tatimor Nr.10873 Prot, date 02.07.2014, pala e paditur i njofton paditesit gjoben ne shumen 30.000 leke, per kryerjen e kundravajtjes administrative te mosdeklarimit te TAP-it (tatimit per te ardhurat personale) ne kohen e duhur per periudhen kohore Qershor 2009, Shtator 2009, Mars 2010.

Paditesi duke mos qene dakord me kete njoftim vleresimi tatimor e kundershkon ate ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin Nr.21184/1 Prot, date 01.10.2014 ka vendosur te lere ne fuqi aktin administrativ njoftim vleresimi te nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe.

Gjate gjykimit paditesi pretendoi se akti administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt administrativ i kundraligjshem sepse detyrimet tatimore jane falur ne baze te ligjit Nr.10418, date 21.04.2011.

Pala e paditur ka prapesur duke pretenduar se ky detyrim tatimor nuk eshte falur ne baze te ligjit sepse nuk ka qene i kontabilizuar ne regjistrat tatimore deri ne daten 31.12.2010.

Ne nenin 35 te ligjit Nr. 10418, date 21.04.2011 thuhet: *"E drejta e subjekteve qe te perfitojne nga legalizimi dhe falja ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, mund te ushtrohet deri ne daten 31.12.2011"*.

Ne te tilla rrethana ky pretendim i pales paditese se detyrimi tatimor i tij eshte faluar ne baze te ketij ligji eshte nje pretendim i pabazuar sepse ky detyrim

nuk është kontabilizuar deri në datën 31.12.2010 dhe kjo e drejte nuk është ushtruar deri në datën 31.12.2011.

Per keto arsye padia e paditesit është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet rrezuar nga gjykata

Në bazë të nenit 45 të ligjit Nr. 49, datë 03.05.2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankimi, sepse objekt i kerkimit është kundërshtimi i akteve administrative që përmbajnë detyrime në të holla me vlerë më të vogël se njezetfishi i pages minimale në shkallë vendi. Paga minimale në shkallë vendi me bazë të V.K.M Nr.573, datë 03.07.2013 është në masën 22.000 leke, ndërsa njezetfishi i saj është i barabartë me 440.000 leke.

### **PER KETO ARSYE**


Gjykata në bazë të neneve 40, 41 të ligjit Nr. 49, datë 03.05.2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"

### **VENDOSI**

1. Rrezimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditese.
  - Kunder këtij vendimi nuk lejohet ankimi.
  - U shpall sot me datë 17.02.2015 në Korçë.


**SEKRETARE**

**MARINELA RUSHI**



**GJYQTAR**

**SOKOL IBI**



Shpenzimet gjyqësore:

1. Takse pulle 3.000 leke;  
Totali 3.000 leke (të parapaguara nga paditesi).

**Shenim:** Vendimi ka marre forme te prere sot ne daten \_\_\_\_\_ .

**KANCELAR  
ALEKSANDER DINO**